

Njoftim për Punësim Jurist

| | |
|--------------------------|-----------------------------------------------------|
| Pozicioni | Jurist |
| Projekti | Mbështetje Ligjore për shtetasit afganë në Shqipëri |
| Zonat e projektit | Bashkia Lezhë dhe Durrës |
| Kohëzgjatja e projektit | 01 Dhjetor 2021 – 30 Shtator 2022 |
| Lloji i kontratës | Kontratë Pune Individuale me kohë të plotë |
| Data e fillimit të punës | 01.12.2021 |

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS kërkon të punësojë **dy juristë që do të ofrojnë shërbime ligjore cilësore për të gjithë personat e identifikuar në nevojë** për këtë lloj shërbimi, në kuadër të projektit “Mbështetje ligjore për shtetasit afganë në Shqipëri” të zbatuar nga Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS me mbështetjen e IRC.

Rreth Nisma ARSIS

Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS (shkurtimisht Nisma ARSIS) është një organizatë jofitimprurëse e cila është themeluar në shkurt të vitit 2016. Nisma ARSIS është një aktor jo qeveritar me influencë në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri.

Misioni i Nisma ARSIS është të ofrojë shërbime dhe zgjidhje të qëndrueshme për individë dhe grupet më të marginalizuara në shoqërinë shqiptare me theks të veçantë në komunitetet Rome dhe Egjiptiane. Nisma ARSIS advokon dhe lobon në nivel lokal dhe qendror mbi çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të rinjve, zhvillimit dhe pjesëmarrjes, përmirësimit të kushteve social-ekonomike të familjeve të tyre dhe fuqizimit të kapaciteteve të shërbimit ofruesve, organizatave jofitimprurëse, profesionistëve dhe aktorëve të tjerë të cilët punojnë me fëmijët në situatë vulnerabël.

Rreth projektit

Pas pushtimit të Kabulit prej talibanëve në mesin e gushtit 2021, situata e sigurisë në Afganistan u përkeqësua dhe nevoja për zhvendosje u bë më urgjente. Qeveria e Shqipërisë shprehu gatishmërinë për të pritur përkohësisht shtetasit afganë që aplikojnë ose për programin e vizave speciale emigruese (SIV) të krijuar nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara ose për vizat P1 dhe P2 përmes Programit të SHBA për pranimin e refugjatëve. Projekti do të punojë për të siguruar që refugjatët dhe azilkërkuesit nga Afganistani të marrin/aksesojnë informacione dhe këshilla ligjore cilësore që lidhen me ligjin për të huajt apo ligjin për azilin dhe jo vetëm. Përmes ndërgjegjësimit ligjor, familjet do të kenë një mjedis të favorshëm për aksesin e ndihmës juridike. Stafit dhe mbikëqyrësit e vijës së parë do të kenë akses të barabartë në njohuritë, kompetencat dhe aftësitë e nevojshme për të ofruar informacion për familjet

Grupet përfituese:

- Shtetasit afganë (të rritur dhe fëmijë) të akomoduar në Bashkinë Lezhë dhe Durrës;

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Të punosh me refugjatët është një kontekst i ri në Shqipëri, që shoqërohet me nevojën për shërbime gjatë gjithë planit të mbështetjes së tyre. Adresimi i shqetësimeve që lidhen me kushtet ligjore për

shtetasit afganë të vendosur në Shqipëri është një çështje shumë e ndjeshme e cila lidhet me kërkesa specifike për zhvendosjen e tyre drejt vendeve të tjera. Për këtë arsye Nisma ARSIS nëpërmjet stafit (në përbërje ka edhe jurist) të punësuar synon të sigurojë që komuniteti i shtetasve afganë në Shqipëri të kuptojnë, qartësohen, sigurojnë dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre për të kërkuar azil nëse nevojitet apo të përfitojnë nga mbrojtja ndërkombëtare kur është e mundur. Stafi jurist dohet të trajtojë dhe adresojë drejt zgjidhjes të gjitha problematikat ligjore që identifikohen tek ky komunitet i akomoduar në territorin e Bashkive Lezhë dhe Durrës.

Roli dhe përgjegjësitë e juristit si pjesë e ekipit psiko-social do të fokusohen në:

- Krijimin e infrastrukturës që mbështet përpjekjet e vazhdueshme për përshtatje sipas nevojave;
- Sigurimin e mbikëqyrjes dhe menaxhimit të rasteve për shtetasit afganë;
- Të realizojë vlerësimin e nevojave ligjore për shtetasit afganë;
- Të ndihmojë shtetasit afganë në paraqitjen e kërkesave për plotësimin e procedurave për lejen humanitare;
- Mbështetje për pranimin e refugjatëve nga SHBA në programet P-1, P-2, SIV ose Azil Politik;
- Mbështetje ligjore pro bono nga firmat ligjore;
- Të sigurojë përfaqësim të drejtpërdrejtë për shtetasit afganë në çështjet e imigracionit dhe familjes përpara USCIS, EOIR dhe gjykatave;
- Zhvillimi i rekomandimeve për politikën e zhvendosjes për të identifikuar pikat e forta, pikat e dobëta dhe risqet;
- Ndjekjen e procedurave sipas ligjeve në fuqi për të gjitha çështjet e mbrojtjes nga dhuna për cdo individ, grua, fëmijë, i rritur, si në kushtet e marrëdhënieve familjare dhe më tej;
- Të orientojë dhe të kryejë procedurat për regjistrimet e çdo fëmije të lindur gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri, brenda apo jashtë martese;
- Të orientojë dhe të kryejë procedurat për lejet e punës në Shqipëri për shtetasit afganë të interesuar;
- Prodhimin e një raporti që përmban rekomandime për të rritur efikasitetin, sigurinë, planifikimin dhe zbatimin e tyre në operacionet e tyre të përditshme;
- Përgatitjen e materialeve orientuese, këshilluese (fletë palosje) për të gjitha çështjet e identifikuara nga vlerësimi i nevojave;
- Organizimi i sesioneve këshilluese dhe ndërgjegjësuere për shtetasit afganë në nivelin bazë të njohurive ligjore për të drejtat dhe detyrimet e tyre në këtë proces;
- Detyra të tjera të caktuara në përshkrimin e punës;
- Raportimin e rasteve në nevojë për mbrojtje si fëmijë apo të rritur (raste të identifikuara gjatë aktiviteve apo punës në terren me vëmendje të shtuar ndaj rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare).

Kualifikime dhe eksperiencë e punës:

- Diplomë universitare dhe master shkencor në shkencat juridike;
- Njohuri dhe kualifikime që lidhen me çështje të emigracionit (për fëmijë dhe të rritur);
- Njohuri dhe kualifikime që lidhen me çështje të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve dhe familjeve;
- Njohuri shumë të mira dhe eksperiencë të mëparshme në ndjekjen e procedurave të aplikimit për viza për Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera;
- Njohuri shumë të mira të paketës ligjore të shërbimeve shoqërore;
- Përvojë të punës në ekip për koordinimin e veprimeve për realizimin e planeve të ndërhyrjes ndaj individëve në nevojë;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe të përshtaten sipas nevojave të punës në grup

- Aftësi ndërvepruese dhe komunikuese shumë të mira
- Dëshirë dhe mundësi për të udhëtuar në terren dhe për të punuar me kategoritë vulnerabël;
- Të jenë të gatshëm për të filluar punë menjëherë
- Aftësi të mbledhë, analizojë dhe përpunojë të dhënat me vëmendje në detaje dhe saktësi
- Kërkohen njohuri shumë të mira të gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze në të folur, lexuar dhe shkruar;
- Aftësi shumë të mira në përdorimin e paketës MS Office
- Të kuptojë dhe të dakordësojë me misionin dhe qëllimin e Nisma ARSIS, politikat e Mbrojtjes dhe të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri;

Politikat e Mbrojtjes: Të gjithë personat që punojnë me programet e Nisma ARSIS janë të detyruar të respektojnë politikat e mbrojtjes së fëmijëve, politikat e mbrojtjes nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, kodin e sjelljes bashkëngjitur me termat e referencës.

Koha e mundshme e fillimit të punës është 1 Dhjetor 2021.

Procedura e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e juristit duhet të dërgojnë me email:

- 1- Shprehje interesi
- 2- Curriculum Vitae (evidenca të punëve të mëparshme të ngjashme);

Gjithë dokumentacioni i aplikimit duhet të dorëzohet në adresën e emailit: initiative.arsis@gmail.com deri në datën **29.11.2021**, mesnatë, me subjekt: Aplikimi për “Jurist pranë NISMA ARSIS”.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur për fazën e intervistimit për pozicionin e juristit do të kontaktohen.